



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:075007

Datë: 24.10.2024

Numri i dokumentit: 06343918

P.nr.470/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykues Diora Bajrami, me pjesëmarrjen e praktikantes L.B. në çështjen penale kundër të pandehurit J.D. nga fshati Komuna Prizren, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren –Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.730-2/2020 e datës 24.06.2020 duke vendosur sipas detyrës zyrtare, më datë 24.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren –Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.730-2/2020 e datës 24.06.2020.

PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit -tani të ndjerit J.D. nga fshati Komuna Prizren, i akuzuar për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK, për shkak të vdekjes së të pandehurit.

Shpenzimet e procedurës penale bien në llogari të mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate me dt. 24.06.2020, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.730-2/2020 e datës 24.06.2020, kundër të pandehurit J.D.nga fshati Komuna Prizren, për shkak dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale me dt. 27.11.2023, 29.01.2024, 11.04.2024 dhe me dt. 09.07.2024 mirëpo të njejtat nuk janë mbajtur për shkak se është konstatuar se i pandehuri ka vdekur.

Në një rrethanë të tillë gjykata me dt. 09.07.2024 i është drejtuar Komunës së Prizrenit – Drejtorisë për Administratë – Sektori për Gjendje Civile për të verifikuar nëse i pandehuri ka vdekur, e në rast se po, atëherë është kërkuar certifikata e vdekjes dhe me dt. 17.07.2024 nga

Zyra e Gjendjes Civile është njoftuar se sipas të dhënave që kanë në sistemin e tyre i pandehuri J.D. i lindur me dt. në fshatin Komuna Prizren ka vdekur me ç ‘rast gjykatës i kanë bashkangjitur certifikatën e vdekjes numër e lëshuar më datë 17.07.2024 për të pandehurin J.D. me numër personal

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në dispozitën e nenit 453 par.1 të KPP-së.

Andaj, nga të lart cekurat, gjykata në bazë të nenit 357 par. 1 pika 1.3 lidhur me nenin 158 të KPPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
- *Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Penal*
P.nr.470/2020 me datë 23.10.2024

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 (tri) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.